



NJOFTIM PËR MEDIA

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në datë 27 janar 2016 në prani të anëtarëve:

Z.Gentian Sala	Kryetar
Z.Sami Nezaj	Zëvendëskryetar
Z.Gledis Gjipali	Anëtar
Z.Piro Misha	Anëtar
Zj.Suela Mustaj	Anëtar
Z.Zylyftar Bregu	Anëtar

mori në shqyrtim aplikimin e shoqërive:

- ❖ “Digitalb” sh.a,
- ❖ “Super Sport” sh.a.,
- ❖ “Top Channel” sh.a,
- ❖ “ Tv Klan” sh.a.

për marrje licence private kombëtare transmetimi audioviziv numerik sipas procedurës Beauty Contest. Në këtë mbledhje u vendos shtyrja e vendimmarrjes për në datën 01.02.2016, ora 9.00, pasi dy nga anëtarët përkatësisht z.Sami Nezaj, zëvendëskryetar dhe Zj. Suela Mustaj, anëtare, kërkuan më shumë kohë për shqyrtimin e dokumentacionit të aplikimit të subjekteve aplikuese.

Në vijim, në datën 01.02.2016 AMA, konkludoi me vendim si më poshtë:

1. Mosdhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv shoqërisë “Digitalb” sh.a.
2. Mosdhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv shoqërisë “Supersport” sh.a.
3. Mosdhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv shoqërisë “Top Channel” sh.a.
4. Mosdhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv shoqërisë “Tv Klan” sh.a.

Tiranë, 1 Shkurt 2016